

Secili që ka pretenduar apo është punësuar në Agjencinë Kosovare të Inteligjencës është “verifikuar” nga një zyrtar që të enjten është arrestuar për falsifikim të diplomës së shkollës së mesme, shkruan kd.

Isuf Lumi (1966) nga Bllaca e Suharekës është zbuluar se nuk e ka të kryer fare shkollën e mesme. Me një diplomë që dyshohet se e ka falsifikuar, pos që është punësuar fillimisht në Policinë e Kosovës, për të kaluar në Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, ka arritur të kryejë fakultetin dhe të regjistrohet në studimet master.

Lumi ka prezantuar një diplomë të shkollës së mesme teknike “Anton Çetta” të Skenderajt. Me të ka arritur që të bëjë karrierë si njëri prej zyrtarëve më të lartë të AKI-së, derisa të enjten është arrestuar si i dyshuar për vepër penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar dhe legalizim të përmbajtjes së pavërtetë.

Burime në organet e ndjekjes kanë thënë se Lumi është pranuar në Polici për shkak të lidhjeve të shumta me politikën. Kur i ishte kërkuar diploma më vonë, kishte dërguar një dokument të një shkolle të Skënderajt të vitit 1985.